

V E N D I M
Nr.436, datë 10.6.1996

PËR GRUMBULLIMIN E GRURIT TË VENDIT, PRODHIM I VITIT 1996

Me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Çmimi i blerjes nga shteti i grurit të vendit, prodhim i vitit 1996 të jetë 20 lekë/kg. Ky çmim është i vlefshëm për grurin konform standardit shqiptar.

2. Për grumbullimin e grurit ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit, ndërmarrjet e grumbullimit të drithit në rrethe që nuk janë privatizuar dhe NTG Durrës.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit për grumbullimin e grurit do të përdorë fondet kundërparti të ndihmave, fondet buxhetore dhe mjetet e veta.

4. Ndërmarrjet në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit për grumbullimin e grurit do të përdorin fondet e mbetura që i janë dhënë NTG Durrës për emergjencë në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.244, datë 14.6.1994, prej rreth 100 milionë lekësh, dhe që disponohen nga kjo ndërmarrje. Këto fonde do të përdoren nga llogaria bankare e specifikuar "Fond kundërparti për shitjen e grurit dhe të miellit". Brenda datës 21 qershor të njoftohet Këshilli i Ministrave për numrin e mësipërm të llogarisë dhe sasinë e fondeve.

Këto fonde do të shpërndahen në ndërmarrjet që do të përcaktohen nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit në llogaritë e tyre bankare të specifikuar "Fond kundërparti për blerje gruri dhe mielli", çelur sipas udhëzimit përkatës të Bankës Kombëtare Tregtare.

5. Fondet e mësipërme do të përdoren me miratim të Kryetarit të Këshillit të Ministrave, sipas kërkesave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit.

6. Për të ruajtur çmimin tavan të bukës dhe të miellit, gruri i grumbulluar nga subjektet shtetërore sipas pikës 2 të këtij vendimi, do të vazhdojë t'u shitet fabrikave të miellit me çmimin 15,7 lekë/kg.

7. Subjektet që do të grumbullojnë grurë sipas pikës 2 të këtij vendimi, me fondet e vëna në dispozicion për grumbullimin e grurit bëjnë riqarkullimin e fondit të marrë vetëm për grumbullim dhe shitje gruri e mielli gjatë sezonit të grumbullimit 1996, gjithnjë me dëjnen të Kryetarit të Këshillit të Ministrave.

8. Në përfundim të aktivitetit të grumbullimit dhe të shitjes së grurit fondet e mbetura derdhen në llogarinë bankare të specifikuar në pikën 4 të këtij vendimi dhe përdoren vetëm për këtë qëllim me miratim të Kryetarit të Këshillit të Ministrave.

9. Për marrjen në dorëzim të grurit do të zbatohen rregullat e standardit shtetëror dhe të udhëzimit përkatës të përbashkët të Ministrisë së Financave, të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet duke filluar nga data 20 qershor 1996.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi